

SIGURIA NË PUNË PËR PROFESIONISTËT E UJËRAVE TË NDOTURA

Përshkrimi i kursit

Rrjeti i kanalizimeve dhe impianti i trajtimit të ujërave të ndotura, për nga vet natyra dhe vendodhja e tyre, mund të jenë vende të rrezikshme për të punuar.

Ky kurs trajnimi ka si qëllim ndërgjegjësimi e punonjësve që punojnë në këto mjedise, në lidhje me rreziqet që mund të hasin në vendin e tyre të punës, si dhe pajisjen e tyre me njohurit e nevojshme për identifikimin dhe parandalimin e këtyre rreziqeve.



Përveç ndërhyrjeve inxhinierike për krijimin e një ambienti të sigurt pune, sjellja në mënyrë të sigurt dhe përdorimi i pajisjeve të mbrojtjes personale janë fokusi kryesor i këtij trajnimi.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për inxhinierët, teknikët dhe specialistët që punojnë në sektorin e kanalizimeve dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Kuptoni rëndësinë e rregullave dhe procedurave të sigurisë;
- Njihni shkaqet e aksidenteve dhe dëmtimeve në punë;

- Identifikoni rreziqet ekzistuese ose mundshme në ambientin e punës;
- Mbroheni nga dëmtimet fizike,
- infektimet nga uji i ndotur, lëndët kimike helmuese, zhurmat e forta, zjarret, goditjet nga rryma elektrike dhe përzjerjet eksplozive;
- Zbatoni procedurat e sigurisë për hyrjen, punën dhe daljen nga hapësirat e mbyllura;
- Identifikoni llojet e rreziqeve që mund të hasni kur punoni në një sistem kanalizimesh ose impiant të trajtimit të ujërave të ndotura;
- Kuptoni rëndësinë dhe përdorimin e pajisjeve të sigurisë;
- Identifikoni llojet e ndryshme të pajisjeve të sigurisë që përdoren nga punëtorët e ujërave të ndotur;
- Përzgjidhni dhe përdorëni pajisjet e duhura mbrojtëse;

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit të trajnimit

Pjesëmarrësit në këtë kurs trajnimi, do të pajisen me Manualin e Trajnimit "Siguria në Punë për Profesionistët e Ujërave të Ndotura". Përpos kësaj, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 13,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 16,000 lekë për person

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe